



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

PROJEKTLIGJI PËR LOJËRAT MESDHETARE XXI PRISHTINA 2030¹

DRAFT LAW ON THE XXI MEDITERRANEAN GAMES PRISHTINA 2030²

NACRT ZAKONA O XXI MEDITERANSKIM IGRAMA PRIŠTINA 2030³

¹ Projektligji për Lojërat mesdhetare XXI Prishtina 2030, është aprovuar në mbledhjen e 8-të, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me vendimin nr.09/08, të datës, 03.04.2026.

² Draft Law on the XXI mediterranean games Prishtina 2030, has been in the 08, meeting of the Government of the Republic of Kosovo, with the Decision, No.09/08, dated 03.04.2026.

³ ³ Nacrt zakona o XXI mediteranskim igrama Pristina 2030, usvojeno na 08, Sednici Vlade, sa Odlukom Br.09/08, datum 03.04.2026.

<p>Kuvendi i Republikës së Kosovës,</p> <p>Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,</p> <p>Miraton:</p> <p style="text-align: center;">LIGJ PËR LOJËRAT MESDHETARE XXI PRISHTINA 2030</p> <p>KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</p> <p style="text-align: center;">Neni 1 Qëllimi</p> <p>Qëllimi i këtij ligji është të përcaktojë rregullat dhe procedurat, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve shtetërore dhe subjekteve të tjera, lidhur me organizimin dhe funksionimin e edicionit XXI të Lojërave Mesdhetare, Prishtina 2030.</p>	<p>The Assembly of the Republic of Kosova,</p> <p>Pursuant to Article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosova,</p> <p>Adopts:</p> <p style="text-align: center;">LAW ON THE XXI MEDITERRANEAN GAMES PRISHTINA 2030</p> <p>CHAPTER I GENERAL PROVISIONS</p> <p style="text-align: center;">Article 1 Purpose</p> <p>The purpose of this law is to specify the rules and procedures, and the duties and responsibilities of state institutions and other entities, relating to the organization and operations of the XXI edition of the Mediterranean Games, Prishtina 2030.</p>	<p>Skupština Republike Kosova,</p> <p>Na osnovu člana 65. (1) Ustava Republike Kosovo,</p> <p>Usvaja:</p> <p style="text-align: center;">ZAKON O XXI MEDITERANSKIM IGRAMA PRIŠTINA 2030</p> <p>POGLAVLJE I OPŠTE ODREDBE</p> <p style="text-align: center;">Član 1 Cilj</p> <p>Svrha ovog zakona je da odredi pravila i procedure, kao i dužnosti i odgovornosti državnih institucija i drugih subjekata u vezi sa organizacijom i funkcionisanjem XXI izdanja Mediteranskih igara, Priština 2030.</p>
--	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 2 Përkufizimet</p>	<p style="text-align: center;">Article 2 Definitions</p>	<p style="text-align: center;">Član 2 Definicije</p>
<p>1. Termat e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:</p> <p>1.1. Komiteti Ndërkombëtar i Lojërave Mesdhetare (ICMG) – Organizatë ndërkombëtare, joqeveritare dhe jofitimprurëse, që është pronare e Lojërave Mesdhetare;</p> <p>1.2. Shteti Pritës – Republika e Kosovës, e përfaqësuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës;</p> <p>1.3. Qyteti Pritës – Komuna e Prishtinës;</p> <p>1.4. Komiteti Olimpik Kombëtar Pritës – Komiteti Olimpik i Kosovës;</p> <p>1.5. Komiteti Organizativ i Lojërave Mesdhetare (OCMG) – Person juridik i themeluar nga Komiteti Olimpik Kombëtar Pritës, në bashkëpunim me</p>	<p>1. Terms used in this law shall have the following meaning:</p> <p>1.1. International Committee of the Mediterranean Games (ICMG) – an international, non-governmental, non-profit organization, and the owner of the Mediterranean Games;</p> <p>1.2. Host State – the Republic of Kosovo, represented by the Government of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.3. Host City – the Municipality of Prishtina;</p> <p>1.4. Host National Olympic Committee (Host NOC) – the National Olympic Committee of the Republic of Kosovo, also referred to as the Kosovo Olympic Committee;</p> <p>1.5. Organizing Committee of the Mediterranean Games (OCMG) – a legal person established by the Host NOC in cooperation with the host City,</p>	<p>1. Pojmovi upotrebljeni u ovom zakonu imaju sledeće značenje:</p> <p>1.1. Međunarodn komitet Mediteranskih igara (ICMG) – međunarodna, nevladina i neprofitna organizacija koja je vlasnik Mediteranskih igara;</p> <p>1.2. Država domaćin – Republika Kosovo, predstavljena od strane Vlade Republike Kosovo;</p> <p>1.3. Grad domaćin – Opština Priština;</p> <p>1.4. Nacionalni olimpijski komitet države domaćina (NOK domaćina) – Nacionalni olimpijski komitet Republike Kosovo, poznat i kao Olimpijski komitet Kosova;</p> <p>1.5. Organizacijski komitet Mediteranskih igara (OCMG) – pravno lice osnovano od strane NOK-a domaćina u saradnji sa Gradom</p>

<p>Qytetin Pritës, i autorizuar me organizimin e Lojërave Mesdhetare, në bashkëpunim me autoritetet e tjera kompetente;</p> <p>1.6. Karta e ICMG-së – Dokumenti themelor i ICMG-së, i cili përcakton detyrimet e OCMG-së dhe autoriteteve dhe subjekteve kompetente të përfshira në organizimin e Lojërave Mesdhetare;</p> <p>1.7. Kontrata e Qytetit Pritës – Marrëveshja e nënshkruar më 8 shtator 2023 nga përfaqësuesit e Komitetit Ndërkombëtar të Lojërave Mesdhetare, Komitetit Olimpik të Kosovës, Komunitetit të Prishtinës dhe, si dëshmitarë, Ministri i Financave dhe Ministri i Ministrisë së Sportit dhe Rinisë të Qeverisë së Republikës së Kosovës;</p> <p>1.8. Dokumenti i Kandidaturës – Dosja e kandidaturës për Lojërat Mesdhetare XXI Prishtina 2030, e cila është pjesë integrale e Kontratës së Qytetit Pritës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 3 Statusi i Kartës së ICMG-së, Kontratës së Qytetit Pritës dhe Dokumentit të Kandidaturës</p>	<p>entrusted with the organization of the Mediterranean Games, in collaboration with other competent authorities;</p> <p>1.6. ICMG Charter – the governing document of the ICMG outlining the obligations of the OCMG and the competent authorities and entities involved in the organization of the Mediterranean Games;</p> <p>1.7. Host City Contract – Agreement signed by representatives of the International Committee of the Mediterranean Games, the Kosovo Olympic Committee, the Municipality of Prishtina, and, as witnesses, the Minister of Finance and the Minister of the Ministry of Sports and Youth of the Government of the Republic of Kosovo, on September 8, 2023;</p> <p>1.8. Candidacy Document – The Prishtina 2030 Candidature Dossier for the XXI Mediterranean Games, an integral part of the Host City Contract.</p> <p style="text-align: center;">Article 3 Status of the ICMG Charter, Host City Contract, and Candidacy Document</p>	<p>domaćinom, kojem je poverena organizacija Mediteranskih igara, u saradnji sa drugim nadležnim organima;</p> <p>1.6. Povelja ICMG – upravljajući dokument ICMG-a koji definiše obaveze OCMG-a i nadležnih organa i subjekata uključenih u organizaciju Mediteranskih igara;</p> <p>1.7. Ugovor o Gradu domaćinu – Sporazum potpisan od strane predstavnika Međunarodnog komiteta Mediteranskih igara, Olimpijskog komiteta Kosova, Opštine Priština, i, kao svedoci, Ministra finansija i Ministar Ministarstva sporta i omladine Vlade Republike Kosovo, dana 8. septembra 2023. godine;</p> <p>1.8. Dokument o kandidaturi – Dosije kandidature Prištine 2030 za XXI Mediteranske igre, koji je sastavni deo Ugovora o Gradu domaćinu.</p> <p style="text-align: center;">Član 3 Status Povelje ICMG-a, Ugovora o Gradu domaćinu i Dokumenta o kandidaturi</p>
---	---	---

<p>Ky ligj është në përputhje me Kartën e ICMG-së, Kontratën e Qytetit Pritës dhe Dokumentin e Kandidaturës. Qeveria, Komiteti Olimpik Kombëtar Pritës, Qyteti Pritës dhe OCMG-ja janë përgjegjës për përmbushjen e të gjitha detyrimeve përkatëse, të përcaktuara në këto dokumente.</p> <p>KAPITULLI II PËRGJEGJËSITË E AUTORITETEVE KOMPETENTE</p> <p>Neni 4 Përgjegjësitë e Qeverisë së Republikës së Kosovës</p> <p>1. Qeveria duhet të miratojë shfrytëzimin e fondeve publike për organizimin e Lojërave Mesdhetare, në shumën prej të paktën €253,445,501 (dyqind e pesëdhjetë e tre milionë e katërqind e dyzet e pesë mijë e pesëqind e një euro), duke u bazuar në respektimin e plotë të vlerave publike siç parashihet në paragrafin 2 të këtij neni. Për kosto operacionale, fonde përkatëse i alokohen OCMG-së, sipas referencës në Dokumentin e Kandidaturës.</p> <p>2. Qeveria ka përgjegjësi të sigurojë që parimet e transparencës, efikasitetit, integritetit, antikorrupsionit, barazisë së</p>	<p>This law is in accordance with the ICMG Charter, the Host City Contract, and the Candidacy Document. The Government, Host NOC, Host City, and the OCMG are responsible for fulfilling all of their respective obligations as stipulated in these instruments.</p> <p>CHAPTER II RESPONSIBILITIES OF COMPETENT AUTHORITIES</p> <p>Article 4 Responsibilities of the Government of the Republic of Kosova</p> <p>1. The Government shall approve the use of public funds for the organization of the Mediterranean Games, in the amount of at least € 253,445,501, conditioned on full respect for the public values indicated in paragraph 2 of this Article. The relevant funds shall be allocated to the OCMG for operations costs according to the reference in the Candidacy Document.</p> <p>2. The Government has the responsibility to ensure that the principles of transparency, efficiency, integrity, anti-</p>	<p>Ovaj zakon je u skladu sa Poveljom ICMG-a, Ugovorom o Gradu domaćinu i Dokumentom o kandidaturi. Vlada, NOK domaćina, Grad domaćin i OCMG su odgovorni za ispunjenje svih svojih odgovarajućih obaveza utvrđenih ovim aktima.</p> <p>POGLAVLJE II ODGOVORNOSTI NADLEŽNIH ORGANA</p> <p>Član 4 Odgovornosti Vlade Republike Kosova</p> <p>1. Vlada odobrava upotrebu javnih sredstava za organizaciju Mediteranskih igara, u iznosu od najmanje 253.445.501 evra, uz uslov da se u potpunosti poštuju javne vrednosti navedene u stavu 2 ovog člana. Odgovarajuća sredstva biće dodeljena OCMG-u za operativne troškove u skladu sa referencama iz Dokumenta o kandidaturi.</p> <p>2. Vlada ima odgovornost da obezbedi poštovanje principa transparentnosti, efikasnosti, integriteta, borbe protiv</p>
--	--	--

<p>mundësive, mosdiskriminimit dhe standardeve të tjera etike, të respektohen në shpenzimin e fondeve publike për organizimin e Lojërave Mesdhetare. Qeveria duhet të krijojë një njësi të veçantë mbikëqyrëse për këtë qëllim.</p> <p>3. Qeveria përfaqësohet në Bordin Drejtues të OCMG-së, në përputhje me nenin 13 të këtij ligji.</p> <p>4. Qeveria do shpallë organizimin e edicionit XXI të Lojërave Mesdhetare, të besuara Komunës së Prishtinës, çështje të interesit publik. Si të tilla, Lojërat kanë përparësi në organizim në fushat përkatëse.</p> <p>5. Qeveria duhet të sigurojë që asnjë vendim i OCMG-së të mos ndryshohet ose të revokohet në mënyrë të njëanshme nga ndonjë autoritet qeveritar, përveç në rast të një vendimi gjyqësor të formës së prerë.</p> <p>6. Së bashku me nënshkruesit e tjerë të Kontratës së Qytetit Pritës, Qeveria duhet të kontribuojë në përmbushjen e të gjitha detyrimeve të përbashkëta të përcaktuara në kontratë, duke qenë në përputhje me Kartën e ICMG-së dhe Kontratën e Qytetit Pritës, sipas roleve përkatëse.</p>	<p>corruption, equal opportunity, non-discrimination, and other ethical standards are respected in the expenditure of public funds for the organization of the Mediterranean Games. The Government shall establish a special oversight unit with this aim.</p> <p>3. The Government shall be represented on the Governing Board of the OCMG in accordance with Article 13 of this Law.</p> <p>4. The Government shall declare the organization of the XXI edition of the Mediterranean Games, assigned to the Municipality of Prishtina, a matter of public interest and as such, shall have priority in operation under relevant fields.</p> <p>5. The Government shall ensure that no decision of the OCMG is unilaterally modified or rescinded by any governmental authority, except by a final and non-appealable judicial decision.</p> <p>6. Together with the other signatories of the Host City Contract, the Government shall contribute to the fulfillment of all joint obligations stipulated in the Contract, in compliance with the ICMG Charter, Host City Contract, in accordance with the respective roles.</p>	<p>korupcije, jednake šanse, nediskriminacije i drugih etičkih standarda u trošenju javnih sredstava za organizaciju Mediteranskih igara. U tom cilju, Vlada će osnovati posebnu jedinicu za nadzor.</p> <p>3. Vlada će biti zastupljena u Upravnom odboru OCMG-a u skladu sa članom 13 ovog zakona.</p> <p>4. Vlada će proglasiti organizaciju XXI izdanja Mediteranskih igara, dodeljenih Opštini Priština, pitanjem od javnog interesa, te će kao takva imati prioritet u delovanju u relevantnim oblastima.</p> <p>5. Vlada će osigurati da nijednu odluku OCMG-a ne može jednostrano izmeniti ili poništiti bilo koji državni organ, osim konačnom i neopozivom sudskom odlukom.</p> <p>6. Zajedno sa ostalim potpisnicima Ugovora o Gradu domaćinu, Vlada će doprineti ispunjenju svih zajedničkih obaveza predviđenih Ugovorom, u skladu sa Poveljom ICMG-a, Ugovorom o Gradu domaćinu i prema odgovarajućim ulogama.</p>
--	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 5 Përgjegjësitë e Komitetit Olimpik të Kosovës</p>	<p style="text-align: center;">Article 5 Responsibilities of the Kosova Olympic Committee</p>	<p style="text-align: center;">Član 5 Odgovornosti Olimpijskog komiteta Kosova</p>
<p>1. Komiteti Olimpik i Kosovës, në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës, është përgjegjës për themelimin e OCMG-së.</p> <p>2. Komiteti Olimpik i Kosovës vepron si ndërmjetës midis OCMG-së dhe palëve të interesit, duke siguruar komunikim dhe koordinim efektiv midis OCMG-së dhe organizatave sportive.</p> <p>3. Komiteti Olimpik i Kosovës duhet të promovojë Lojërat Mesdhetare brenda dhe jashtë Kosovës, me qëllim inkurajimin e pjesëmarrjes vendore dhe ndërkombëtare në Lojërat Mesdhetare dhe nxitjen e një kulture të sportivitetit.</p> <p>4. Me qëllim rritjen e përfaqësimit vendas në Lojërat Mesdhetare, Komiteti Olimpik i Kosovës duhet të mbështesë zhvillimin e sportistëve dhe programeve sportive në Republikën e Kosovës, në përputhje me mbështetjen financiare vjetore të siguruar nga Qeveria për Komitetin Olimpik të Kosovës dhe për federatat sportive, me synim të përgatitjes së ekipit të Kosovës për Lojërat Mesdhetare Prishtina 2030.</p>	<p>1. The Kosova Olympic Committee, in cooperation with the Municipality of Prishtina, is responsible for establishing the OCMG.</p> <p>2. The Kosova Olympic Committee shall act as a liaison between the OCMG and relevant stakeholders, ensuring effective communication and coordination between the OCMG and sporting organizations.</p> <p>3. The Kosova Olympic Committee shall promote the Mediterranean Games both within Kosova and internationally, with the aim of encouraging national and international participation in the Games and fostering a culture of sportsmanship.</p> <p>4. With the aim of increasing national participation in the Mediterranean Games, the Kosova Olympic Committee shall facilitate the development of athletes and sports programs in the Republic of Kosova, in line with the annual financial support provided by the Government to the Kosova Olympic Committee and to the national sports Federations, for the development of sports in Kosova, with the aim of the</p>	<p>1. Olimpijski komitet Kosova, u saradnji sa Opštinom Priština, odgovoran je za osnivanje OCMG-a.</p> <p>2. Olimpijski komitet Kosova deluje kao posrednik između OCMG-a i relevantnih zainteresovanih strana, osiguravajući efikasnu komunikaciju i koordinaciju između OCMG-a i sportskih organizacija.</p> <p>3. Olimpijski komitet Kosova promoviše Mediteranske igre kako u zemlji tako i na međunarodnom nivou, s ciljem podsticanja nacionalnog i međunarodnog učešća na Igrama i negovanja sportske kulture.</p> <p>4. Sa ciljem povećanja nacionalnog učešća na Mediteranskim igrama, Olimpijski komitet Kosova olakšaće razvoj sportista i sportskih programa u Republici Kosovo, u skladu sa godišnjom finansijskom podrškom koju Vlada pruža Olimpijskom komitetu Kosova i nacionalnim sportskim savezima za razvoj sporta u zemlji, s ciljem pripreme kosovskog tima za Mediteranske igre</p>

<p>5. Komiteti Olimpik i Kosovës, në bashkëpunim me OCMG-në, duhet të ndihmojë në zbatimin e programit sportiv të Lojërave Mesdhetare.</p> <p>6. Komiteti Olimpik i Kosovës duhet të koordinohet me federatat sportive për të lehtësuar pjesëmarrjen e sportistëve dhe ekipeve përfaqësuese në Lojërat Mesdhetare.</p> <p>7. Komiteti Olimpik i Kosovës përfaqësohet në Bordin Drejtues të OCMG-së në përputhje me nenin 13 të këtij ligji, Kartën e ICMG-së dhe Kontratën e Qytetit Pritës.</p> <p>8. Së bashku me nënshkruesit e tjerë të Kontratës së Qytetit Pritës, Komiteti Olimpik i Kosovës duhet të kontribuonjë në përmbushjen e të gjitha detyrimeve të përbashkëta të përcaktuara në Kontratë dhe duhet të përmbushë detyrimet e tij sipas Kartës së ICMG-së dhe Kontratës së Qytetit Pritës.</p>	<p>preparation of Kosovo's team for the Mediterranean Games Prishtina 2030.</p> <p>5. The Kosovo Olympic Committee, in cooperation with the OCMG, shall facilitate the implementation of the sporting program of Games.</p> <p>6. The Kosovo Olympic Committee shall coordinate with national sports Federations to facilitate the participation of athletes and teams in the Games.</p> <p>7. The Kosovo Olympic Committee shall be represented on the Governing Board of the OCMG in accordance with Article 13 of this Law, the ICMG Charter and the Host City Contract.</p> <p>8. Together with the other signatories of the Host City Contract, the Kosovo Olympic Committee shall contribute to the fulfillment of all joint obligations stipulated in the Contract, and shall comply with its obligations under the ICMG Charter and the Host City Contract.</p>	<p>Priština 2030.</p> <p>5. Olimpijski komitet Kosova, u saradnji sa OCMG-om, olakšaće sprovođenje sportskog programa Igara.</p> <p>6. Olimpijski komitet Kosova koordiniraće se sa nacionalnim sportskim savezima kako bi omogućio učešće sportista i timova na Igrama.</p> <p>7. Olimpijski komitet Kosova biće zastupljen u Upravnom odboru OCMG-a u skladu sa članom 13 ovog zakona, Poveljom ICMG-a i Ugovorom o Gradu domaćinu.</p> <p>8. Zajedno sa ostalim potpisnicima Ugovora o Gradu domaćinu, Olimpijski komitet Kosova će doprineti ispunjenju svih zajedničkih obaveza predviđenih Ugovorom, te će poštovati svoje obaveze u skladu sa Poveljom ICMG-a i Ugovorom o Gradu domaćinu.</p>
---	---	---

<p style="text-align: center;">Neni 6 Përgjegjësitë e Komunës së Prishtinës si Qyteti Pritës</p>	<p style="text-align: center;">Article 6 Responsibilities of the Municipality of Prishtina as Host City</p>	<p style="text-align: center;">Član 6 Odgovornosti Opštine Priština kao Grad domaćin</p>
<p>1. Komuna e Prishtinës bashkëpunon me Komitetin Olimpik të Kosovës në themelimin e OCMG-së.</p> <p>2. Komuna e Prishtinës duhet t’ia paraqesë Komitetit Ekzekutiv të ICMG-së një plan të detajuar për parandalimin e “reklamimit sulmues” (<i>ambush marketing</i>) dhe duhet të respektojë të gjitha kushtet dhe përcaktimet, duke përfshirë respektimin e plotë të nenit 35 të Kontratës së Qytetit Pritës.</p> <p>3. Komuna e Prishtinës duhet të sigurojë që nuk ka programe të tjera komerciale, reklamuese apo promovuese në Kosovë të organizuar nga Federatat kombëtare sportive, organizata sportive apo entitete publike dhe private, që iu referohen Lojërave Mesdhetare apo Ekipeve Mesdhetare gjatë vitit të Lojërave, apo që nënkupton çfarëdo lidhjeje me to.</p> <p>4. Komuna e Prishtinës duhet të sigurojë që asnjë e drejtë komerciale e lidhur me Qytetin Pritës dhe agjencitë e tij nuk do të</p>	<p>1. The Municipality of Prishtina shall cooperate with the Kosova Olympic Committee in the establishment of the OCMG.</p> <p>2. The Municipality of Prishtina will present a detailed plan to the ICMG Executive Committee for the prevention of marketing and will agree to all terms and conditions and fully comply with the provisions of Article 35 of the Host City Contract.</p> <p>3. The Municipality of Prishtina will ensure that there are no other commercial, marketing, or promotional programs in Kosovo organized by national sports federations, sports organizations, and other public and private entities referring to the Mediterranean Games and/or Mediterranean teams, during the year of the Games or implying any connection with them.</p> <p>4. The Municipality of Prishtina will ensure that no commercial rights related to the</p>	<p>1. Opština Priština sarađivaće sa Olimpijskim komitetom Kosova u osnivanju OCMG-a.</p> <p>2. Opština Priština predložiće Izvršnom komitetu ICMG-a detaljan plan za prevenciju “ambush” marketinga i poštujući sve uslove i odredbe, u potpunosti će se pridržavati odredbi Člana 35 Ugovora o Gradu domaćinu.</p> <p>3. Opština Priština mora da obezbedi da na Kosovu ne postoje drugi komercijalni, reklamni ili promotivni programi koje organizuju nacionalni sportski savezi, sportske organizacije ili javna i privatna lica, a koji se odnose na Mediteranske igre ili Mediteranske timove tokom godine igara. , ili impliciraju bilo kakvu vezu sa njima.</p> <p>4. Opština Priština osiguraće da nikakva komercijalna prava povezana sa Gradom domaćinom i njegovim agencijama neće</p>

<p>jepet për periudhën e Lojërave Mesdhetare pa miratimin me shkrim të ICMG-së.</p> <p>5. Komuna e Prishtinës është e obliguar të kryejë funksionet e saj duke respektuar kushtet e Kontratës së Qytetit Pritës, Kartën e ICMG-së, Dokumentin e Kandidaturës, këtë ligj dhe akte të tjera ligjore përkatëse që zbatohen për administrimin e qeverisjes lokale, me qëllim të organizimit të Lojërave Mesdhetare në mënyrë efikase, të shpejtë dhe profesionale.</p> <p>6. Komuna e Prishtinës përfaqësohet në Bordin Drejtues të OCMG-së në përputhje me nenin 13 të këtij ligji, Kartën e ICMG-së dhe Kontratën e Qytetit Pritës.</p> <p>7. Së bashku me nënshkruesit e tjerë të Kontratës së Qytetit Pritës, Komuna e Prishtinës do të kontribuojë në përmbushjen e të gjitha detyrimeve të përbashkëta të përcaktuara në Kontratë dhe do të përmbushë detyrimet e saj sipas Kartës së ICMG-së dhe Kontratës së Qytetit Pritës.</p>	<p>Host City and its agencies are granted for the period of the Mediterranean Games without the written approval of the ICMG.</p> <p>5.The Municipality of Prishtina is obliged to perform its functions in compliance with the terms of the Host City Contract, the ICMG Statute, the Candidature Document, this Law, and other relevant applicable legal acts of the local government administration, with the aim of organizing the Mediterranean Games in an efficient, timely, and professional manner.</p> <p>6.The Municipality of Prishtina will be represented on the OCMG Governing Board in accordance with Article 13 of this Law, the ICMG Statute, and the Host City Contract.</p> <p>7.Together with the other signatories of the Host City Contract, the Municipality of Prishtina will contribute to fulfilling all joint obligations specified in the contract and will comply with its obligations under the ICMG Charter and the Host City Contract.</p>	<p>biti dodeljena za vreme trajanja Mediteranskih igara bez pismenog odobrenja ICMG-a.</p> <p>5. Opština Priština je dužna da obavlja svoje funkcije u skladu sa odredbama Ugovora o Gradu domačinu, Poveljom ICMG-a, Dokumentom o kandidaturi, ovim Zakonom i drugim relevantnim pravnim aktima koji se primenjuju na lokalnu upravu, s ciljem organizovanja Mediteranskih igara na efikasan, brz i profesionalan način.</p> <p>6. Opština Priština biće zastupljena u Upravnom odboru OCMG-a u skladu sa članom 13 ovog zakona, Poveljom ICMG-a i Ugovorom o Gradu domačinu.</p> <p>7. Zajedno sa ostalim potpisnicima Ugovora o Gradu domačinu, Opština Priština će doprineti ispunjenju svih zajedničkih obaveza predviđenih Ugovorom, te će poštovati svoje obaveze u skladu sa Poveljom ICMG-a i Ugovorom o Gradu domačinu.</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 7 Përgjegjësitë e Komunave të tjera të përfshira</p> <p>Komunat e tjera të përfshira në organizimin e Lojërave Mesdhetare 2030, në bashkëpunim me OCMG-në, janë të obliguara të kryejnë funksionet e tyre në përputhje me kushtet e Kontratës së Qytetit Pritës, Kartën e ICMG-së, Dokumentin e Kandidaturës, këtë ligj dhe akte të tjera ligjore përkatëse që zbatohen për administrimin e qeverisjes lokale, me qëllim të organizimit të Lojërave Mesdhetare në mënyrë efikase, të shpejtë dhe profesionale.</p>	<p style="text-align: center;">Article 7 Responsibilities of Other Involved Municipalities</p> <p>Other involved municipalities in the organization of the 2030 Mediterranean Games, in cooperation with the OCMG, are obliged to perform their functions in compliance with the terms of the Host City Contract, the ICMG Statute, the Candidature Document, this Law, and other relevant legal acts applicable to local government administration, with the aim of organizing the Mediterranean Games in an efficient, speedy, and professional manner.</p>	<p style="text-align: center;">Član 7 Odgovornosti drugih uključenih opština</p> <p>Ostale opštine uključene u organizaciju Mediteranskih igara 2030. godine, u saradnji sa OCMG, dužne su da obavljaju svoje funkcije u skladu sa uslovima Ugovora sa gradom domaćinom, Poveljom ICMG-a, Dokumentom o kandidaturi, ovim zakonom i drugim relevantnim pravnim aktima. koji se odnose na administraciju lokalne samouprave, kako bi se Mediteranske igre organizovale na efikasan, brz i profesionalan način.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 8 Lokalitetet e Lojërave Mesdhetare</p> <p>ICMG-ja, duke ia besuar Lojërat Mesdhetare XXI Komunes së Prishtinës, megjithatë ka autorizuar që një ose më shumë sporte specifike mund të zhvillohen në një qytet të Republikës së Shqipërisë, Komiteti Olimpik Kombëtar i së cilës është anëtare e ICMG-së. Në përputhje me Kartën e ICMG-së, palët, me miratim paraprak të ICMG-së, duhet të nënshkruajnë një marrëveshje</p>	<p style="text-align: center;">Article 8 Site of the Mediterranean Games</p> <p>The ICMG, in assigning the XXI Mediterranean Games to the Municipality of Prishtina, has authorized that one or more specific sports may be held in a city of the neighboring Republic of Albania, whose NOC is recognized as a member of the ICMG. In accordance with the ICMG Charter, the interested parties shall proceed, with prior approval by ICMG, with the signature of a cooperation</p>	<p style="text-align: center;">Član 8 Mesto održavanja Mediteranskih igara</p> <p>ICMG, dodeljujući XXI Mediteranske igre Opštini Priština, dozvoljava da se jedan ili više specifičnih sportova održi u nekom od gradova susedne Republike Albanije, čiji je NOC priznat kao član ICMG-a. U skladu sa Poveljom ICMG-a, zainteresovane strane nastaviće, uz prethodno odobrenje ICMG-a, sa potpisivanjem sporazuma o saradnji, pre nego što se uspostavi OCMG.</p>

<p>bashkëpunimi, para themelimit të OCMG-së.</p> <p>KAPITULLI III ORGANIZIMI I EDICIONIT XXI TË LOJËRAVE MESDHETARE PRISHTINA 2030</p> <p style="text-align: center;">Neni 9 Financimi</p> <p>1. Në përputhje me mbështetjen financiare të garantuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në Dokumentin e Kandidaturës, burimi kryesor i financimit për organizimin e Lojërave Mesdhetare do të jetë buxheti i shtetit të Republikës së Kosovës.</p> <p>2. Financimi nga buxheti i shtetit mund të plotësohet me kontribute nga institucione të tjera vendore dhe mekanizma ndërkombëtarë, donatorë, partneritete, sponsorë dhe burime të tjera financimi, me miratimin e OCMG-së dhe me pëlqimin e Komitetit Ekzekutiv të ICMG-së.</p> <p>3. Sponsorët nuk mund të përfitojnë në asnjë mënyrë tjetër, përveçse siç autorizohet nga rregullorja e OCMG-së për sponsorizim, e cila parashikohet në</p>	<p>agreement, prior to the establishment of the OCMG.</p> <p>CHAPTER III THE ORGANIZATION OF THE XXI EDITION OF THE MEDITERRANEAN GAMES PRISHTINA 2030</p> <p style="text-align: center;">Article 9 Financing</p> <p>1. In line with the financial support guaranteed by the Government of the Republic of Kosova in the Candidacy Document, the primary funding source for the organization of the Mediterranean Games shall be the state budget of the Republic of Kosova.</p> <p>2. Funding from the state budget may be supplemented by contributions from other national institutions and international mechanisms, donors, partnerships, sponsors, and various other sources, upon approval by the OCMG and with the permission of the ICMG Executive Committee.</p> <p>3. Sponsors cannot benefit in any way other than as authorized by the OCMG regulation on sponsorship referred to in Article 11, para. 4 of this Law.</p>	<p>POGLAVLJE III ORGANIZACIJA XXI. IZLAGANJA MEDITERANSKIH IGARA PRISHTINA 2030</p> <p style="text-align: center;">Član 9 Finansiranje</p> <p>1. U skladu sa finansijskom podrškom koju je obezbedila Vlada Republike Kosova u Dokumentu o kandidaturi, osnovni izvor finansiranja za organizaciju Mediteranskih igara biće državni budžet Republike Kosova.</p> <p>2. Finansiranje iz državnog budžeta može biti dopunjeno doprinosima drugih nacionalnih institucija, međunarodnih mehanizama, donatora, partnera, sponzora i drugih izvora, uz odobrenje OCMG-a i saglasnost Izvršnog komiteta ICMG-a.</p> <p>3. Sponzori ne mogu ostvarivati nikakve koristi osim onih koje su dozvoljene prema pravilniku OCMG-a o sponzorstvima, kako je navedeno u članu</p>
--	--	---

